

PROCESVERBAL
nga seanca e 17-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele,
mbajtur më 29.5.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 17-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:20 dhe u mbajt në hapësirat e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 16-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 29.5.2023.
2. Propozim për sigurimin e mëtejshëm të mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje të higjienës.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Z. Petrushevski shpjegoi se Propozim-procesverbali nga seanca e 16-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 29.5.2023 për arsye të kuptueshme teknike do të shtyhet deri në fillim të seancës së ardhshme.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për sigurimin shtesë të mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje të higjienës. Ai shpjegoi se ky furnizim publik shpallet për herë të dytë. Gjatë shpalljes së parë nuk u dorëzua asnjë ofertë,

ndërsa në shpalljen e dytë ishin dorëzuar oferta nga 7 ofrues. Në ankandin elektronik asnjë nga ofruesit nuk ka marrë pjesë aktive, që do të thotë se është bërë renditje nga shtatë ofertat e dorëzuara. Shuma e kompanisë që ka dhënë ofertën më të mirë është 1.170.000,00 denarë që për 370.000,00 denarë pa TVSH e kalon shumën e mjeteve të planifikuara. Ai shpjegoi se këto mjete janë siguruar me ribalancin e Planit Financiar për vitin 2023, i cili është miratuar në seancën e kaluar. Për këtë arsye, propozohet që Këshilli të japë miratim për sigurimin shtesë të mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtje të higjienës për nevojat e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për sigurimin shtesë të mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtje të higjienës për nevojat e Agjencisë, dhe si rrjedhojë e kësaj dhe për ndryshimin e Vendimit për nevojë të furnizimi publik, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-223/3

05.06.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v